



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

NJOFTIM PËR RENDIN E DITËS
Mbledhje Jashtëzakondshme
Me Mjete Të Komunikimit Elektronik

Në mbështetje të nenit 57 pika 2/c të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, të nenit 51, të Rregullores së Funkcionimit të Këshillit Bashkiak Durrës, Aktit Normativ të Këshillit Ministrave nr.3, datë 15.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19“, neni 5 “Vendimarrja nga Organet Kolegjiale,, Këshilli Bashkiak Durrës,

NJOFTON:

DITËN E MARTË, DATA 07.07.2020, ORA 17:00, KËSHILLI DO TË MBAJË NJË MBLEDHJE TË JASHTËZAKONDSHME NËPËRMJET MJETEVE TË KOMUNIKIMIT ELEKTRONIK, ME KËTË REND DITE:

****	MIRATIMI I RENDIT TË DITËS TË MBLEDHJES
1. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E DHËNIES SË NDIHMËS FINANCIARE, SIPAS LISTËS SË DYTË TË SUBJEKTEVE PËRFITUES TË PROGRAMIT TË GRANTIT PËR RIKONSTRUKSIONIN OSE RIPARIMIN E SHËTËPIVE INDIVIDUALE OSE TË BANESAVE NË NDËRTESA (PALLATE), TË CILAT JANË KLASIFIKUAR SI OBJEKTE TË PABANUESHME OSE TË DËMTUARA RËNDË APO TË DËMTUARA LEHTË DHE QË NUK DUHEN RINDËRTUAR NGA E PARA, POR KANË NEVOJË PËR PUNIM RIKONSTRUKSIONI OSE RIPARIME, SI PASOJË E DËMTIMEVE NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019

<p>2. Shqyrtim dhe miratim i projekt- vendimit</p>	<p>PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE TË PRISHJES SË DETYRUAR TË 7 PALLATEVE TË NDODHURA NË NJËSITË ADMINISTRATIVE NR.4 DHE NR.5, DURRËS, TË GJITHA PRONË PRIVATE, NË ZBATIM TË EKSPERTIZAVE TË THELLUARA TË HARTUARA NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT, TIRANË</p>
--	---

Në mbështetje të nenit 5 të Aktit Normativ të Këshillit Ministrave nr.3, datë 15.03.2020, të nenit 33, neni 34/1, neni 77 /8 të Rregullores së Funkcionimit të Këshillit Bashkiak Durrës, anëtarët e Komisionit të Këshillit Bashkiak pasi shqyrtojnë me njëri tjetrin elektronikisht projektvendimin përkatës, dërgojnë me email propozimin e tyre (RAPORTIN) mbi projektvendimin sipas grafikut të mëposhtëm.

DATA 07.07.2020

Pika 1 do të shqyrtohet nga:

- a. Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave
- b. Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike
- c. Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike

Pika 2, do të shqyrtohet nga:

- a. Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike
- b. Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës
- c. Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor
- d. Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike

SEKRETARE KËSHILLIT BASHKIAK DURRËS

Dorina Milja